

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BioNTech kompania e vaksinave, mbyll tre fabrika në Gjermani Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/biontech-kompania-e-vaksinave-mbyll-tre-fabrika-ne-gjermani/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 17:23:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:19:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	52572aeb06c527f71a951e6c8d59debb5e492d8f291a436acd6338c45c640804
TEKSTI	94ea630b1731ab904f7d1f0c6a8dcb6b260cf51fe2f120a6c0cd62a496836b07
PAMJA	72819955dc36f00e7ddb322b5b052ceda764feb761b9826b2483651561a623e9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	02b47253cd89bf695b572aecde9605c25a6afd2ce2742692ac3521b6cb049295
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/02b47253cd89bf695b572aecde9605c25a6afd2ce2742692ac3521b6cb049295>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

BioNTech kompania e vaksinave, mbyll tre fabrika në Gjermani



Edi Hallaci

28 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Gjigandi farmaceutik gjerman BioNTech, i cili u bë i njohur në të gjithë botën si kompania që zhvilloi vaksinën kundër koronavirusit, po planifikon të mbyllë tre nga fabrikat e tij në Gjermani, gjë që do të prekë 1,800 vende pune.

Kompania, me seli në Mainz, njoftoi sot se do të mbyllë njësitë e saj në qytetet Tübingen, Marburg dhe Indar-Oberstein, pasi nuk është gjetur asnjë blerës për t'i marrë ato.

Fabrika e Tübingen do të mbyllet në fund të vitit 2027, ajo e Marburgut në fillim të vitit 2028 dhe ajo e Indar-Oberstein në fund të vitit 2028.

BioNTech, së bashku me kompaninë amerikane Pfizer, ishte kompania e parë që mori miratimin për të shitur vaksinën kundër Covid-19, duke fituar miliarda dollarë.

Kompania u bë e famshme në botë, por kërkesa për vaksinat kundër Covid-19 ka rënë për disa vite dhe BioNTech nuk ka sjellë në treg asnjë produkt tjetër.

BioNTech shpjegon në njoftimin e saj se dështimi i saj për të shitur fabrikat e saj është kryesisht për shkak të tregut aktual të vështirë dhe klimës së investimeve.

Për të siguruar që mbyllja e objekteve të kryhet në një mënyrë shoqërisht të përgjegjshme, janë rënë dakord me këshillin e punës së kompanisë për kushte shtesë të shkurtimit të vendeve të punës, tha kompania në njoftim.

BioNTech, e cila punëson afërsisht 7,200 njerëz në të gjithë botën, ka kaluar nëpër një proces transformimi dhe ristrukturimi për disa vite. Hulumentet janë duke u zhvilluar për një gamë të gjerë produktesh të reja, veçanërisht në fushën e onkologjisë.

Kompania po përqendrohet gjithashtu në imunoterapitë e bazuara në mRNA dhe përdorimin e

kombinuar të antitrapave dhe ilaçeve. Qëllimi është të përdoren antitrapat për shpërndarje më të synuar të ilaçeve të kimioterapisë në qelizat kancerogjene.

E gjithë kjo kushton shumë para dhe BioNTech ka pësuar humbje të konsiderueshme. Në gjysmën e parë të këtij viti, rezultatet neto treguan një humbje prej 1.35 miliardë eurosh.

Përveç kësaj, drejtuesit kryesorë dhe themeluesit e kompanisë, Ugur Sahin dhe Ozlem Turecci, do të largohen nga kompania deri në fund të vitit dhe do t'i përkushtohen zhvillimit të gjeneratës së ardhshme të barnave të bazuara në mRNA në një kompani të re.

LAJME TË NGJASHME



Granit Xhaka pranon fajin dhe largohet nga Kombëtarja, por refuzon të dorëzojë shiritin e kapitenit

1 MIN



Alarm në Zvicër për Granit Xhakën, prokuroria hap hetim për certifikatat e COVID-it

3.5 MIN



Arrestohet kryebashkiaku i qytetit Lawrence në Massachusetts, dyshohet se përvetësoi 1.5 milionë dollarë nga fondet e ndihmës për COVID-19!

1 MIN



Trump nënshkruan urdhrin e ri për vaksinat e fëmijëve/ Kufizohen në 11 rekomandimet për vaksinimin!

1 MIN



Nga erdhi COVID-19? Fauci refuzon t'u përgjigjet pyetjeve në Senat, përdor Amendamentin e Pestë

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



"Patëm një dasmë të madhe shqiptare..." / Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpigjet t'u japë këshilla për dashurinë?



Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për



"Para nga qielli"/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e



Nga dhoma e hotelit me Guardiolen te 15 vite si drejtor i



"Villa Sol Lumière", një oaz paqeje larg kaosit të qytetit!



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi

trajtimin une pagesen...

zouakut:

Lazios une aventura te muani,
Igli Tare në një rrëfim ndryshe!

zouon nungen me piqjen e
trurit!

EDITORI SUGJERON



5 suplemente që mund të
mbështesin efektin e ilaçeve për
dobësim...



7 ushqime që mund t'i
përkeqësojnë efektet anësore
nëse jeni duke marrë Ozempic!



"Villa Sol Lumière", një oaz
paqeje larg kaosit të qytetit!



Molla apo dardha?! Ja se cili frut
është më i shëndetshëm...



Vjeshta kalohet më bukur me
muzikën e përzgjedhur nga
DeeJay-t e TAR!



Këshilli i Sigurisë Kombëtare
mbledhet urgjentisht pas rastit të
Vlora Hysenit, Muhamed Veliu
jep detajet: Kush do të jetë në
krye të SHISH?



Apple surprizon me risitë, AI bën
gabimin e frikshëm dhe Tesla
rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja
se kur tradhtojnë çiftet në një
lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla
Roadster rikthehet me një
premtim të çmendur: Makina që
mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI
ngriti në këmbë ushtrinë e
SHBA-së, gati për sulm! Ja si
ndodhi gjithçka...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të
zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet
informativ dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,
Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top
Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo
riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

LINKS

Kontakti
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.